



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 58-të, të mbajtur më 23 korrik 2018, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegji "Universum":
 - Biznes dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, dega ne Gjakovë, dhe
 - Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 180 ECTS, dega ne Ferizaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencia e Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e përcaktuar nga AKA, BPrAL Kolegji "Universum" ka dorëzuar listat e kërkuara nga AKA për programet e studimit.

Bazuar ne te dhënat e prezantuara nga ky IAL, për programin e studimit: Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 180 ECTS, dega ne Ferizaj (sipas kërkesës së AKA-së datë 23.05.2018) konfirmohet se për këtë program të studimit nuk ka asnjë staf akademik adekuat si bartës të programeve të cekura me lartë.

Për programin e studimit: Biznes dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, dega ne Gjakovë, BPrAL Kolegjit "Universum" si bartës të këtij programi të studimit ka vendosur: Samet Dalipi, dhe Mandeep Chandhary. Pas kontrollimit te dokumentacionit te kualifikimit për secilin bartës të këtij programi të studimit, u konstatua që Samet Dalipi si bartës i këtij programi të studimit nuk ka nostifikim (njohje të diplomës nga MASHT) të diplomës. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, pika 1,5 dhe 6, thuhet që: për qellim të punësimit, këto diploma duhet të nostifikohen nga MASHT. Ndërsa stafi tjetër i paraparë për këtë program të studimit është i fushës së Inxhinierisë Elektrike, dhe nuk ka te bëjë fare me programin e studimit Biznes dhe Menaxhment.


Sipas nenit 26, pika 5.3.4 kërkohet që: “Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD apo titull të barasvlershëm artistik nga fusha e programit të studimeve”. Pra siç mund të shihet nga sa u tha me sipër, kërkohet që për çdo 60 ECTS, IAL duhet të ketë një person në marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore PhD dhe të jetë i fushës së programit të studimit.

Në nenin 21, pika 1 e UA për Akreditim (9/2017), thuhet se: “AKA e rezervon të drejtën të monitoroj dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim”. Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 26 të UA për Akreditim thuhet: “AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe/ apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur”. Bazuar në këtë çka u tha me sipër dhe në mungesë të stafit akademik adekuat, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegjit Universum;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

